



**Kuvendi i Komunës Klinë**

01Nr. 361-37126 /2024

Datë: 01, 11 /2024

*Duke u bazuar në nenin 17 shkronja a) dhe nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr.03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, si dhe nenin 3, paragrafi 3.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087. Nenin 26 të Rregullores QRK nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës. Dispozitat e nenit 10 të Statutit të Komunës së Klinës, nr. 01-110-1232/2010 të miratuar me datën 31.03.2010, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës 01-361-33001/2024 të datës 02.10.2024 si dhe me rekomandimin e KPF-së, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IX-të të rregullt të mbajtur më datën 25.10.2024, mori këtë:*

**VENDIM**

*Për*

*dhënien në shfrytëzim të lokaleve komunale kompanisë NLP – KRM “Ambienti” Njësia Klinë*

1. Miratohet, Propozimi i kryetarit të Komunës së Klinës, nr. **01-361-33001/2024** i datës **02.10.2024** për dhënien në shfrytëzim të lokaleve komunale kompanisë NLP KRM “Ambienti” Njësia Klinë.
2. Lokalet të cilat jepen në shfrytëzim, gjinden në objektin “Nojtra” në Klinë, rruga “Lidhja e Prizrenit”, kati 3, lokali me numër të njësisë **O-71006024-00537-2-1-1-28-0** me sipërfaqe **27 m<sup>2</sup>**, si dhe lokali me numër të njësisë **O-71006024-00537-2-1-1-33-0** me sipërfaqe prej **32 m<sup>2</sup>**.
3. Dhënia në shfrytëzim të përkohshëm të dy lokaleve komunale bëhet për periudhën 3 vjeçare, me pagesë të qirasë mujore të paraparë sipas dispozitave të Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale në Komunën e Klinës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet kryetari i komunës në bashkëpunim me drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
5. Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së konform nenit 81 të LVL-së, përkatësisht 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës së Klinës.

**Me këtë vendim njoftohen:**

- **MAPL;**
- **Kryetari i Komunës;**
- **Kompania NLP KRM “Ambienti” Njësia Klinë;**
- **Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;**
- **Zyra për Informim;**
- **Arkivi;**



**Kryesues i Kuvendit  
Fadil Gashi**